



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 320/01-4384/26
Kaçanik, 26.02.2026

Në bazë të nenit 11,12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), neni 17 paragrafi 1 shkronja g) dhe neni 40 paragrafi 1 dhe 2 shkronja i) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 12 paragrafi 1.6 dhe neni 31 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 i Rregullores (QRK) Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të Tjera, ndërlidhur me nenin 90 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.04/L027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë të tjera, të Propozim Vëndimit të Kryetarit të Komunës përmes Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, 01Nr. 320/01-4384/26 prej datës 16.02.2026, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 26 shkurt 2026, mori këtë:

VENDIM

Për miratimin e Raportit Përfundimtar Nr.08-320/01-26224/2025 të datës 14.11.2025 i hartuar nga Komisioni Komunal mbi Vlerësimin e Dëmeve të Shkaktuara nga reshjet e borës të datës 02.10.2025 në territorin e Komunës së Kaçanikut-në fshatin Stagovë, fermerit **Hajdin Teneqja**, në vlerë prej ██████€

1. Miratohet Vendimi për Miratimin e Raportit Përfundimtar i hartuar nga komisioni komunal më datën 14.10.2025 mbi vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga të reshurat e borës të datës 02.10.2025 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Stagovë, fermerit Hajdin Teneqja, në vlerë ██████€.

2. Me miratimin e këtij vendimi, miratohet Raporti i dëmeve i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, i shqyrtuar dhe miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, raporti përmban një vlerësim profesional nga të dhënat evidentuara dhe të regjistruara nga dalja në vendshikim të komisionit komunal të emëruar nga Kryetari i Komunës dhe kërkesës për kompensim të dëmeve nga (familjet) e dëmtuar nga të reshurat e breshrit të cekur në pikën 1 dhe i njëjti raport i miratuar nga Kuvendi i Komunës në afat ligjor prej 15 ditëve nga dita e miratimit i dorëzohet Agjencionit të Menaxhimit të Emergjencave dhe një kopje të njëjtësuar Komisionit Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

3. Ky vendim pas miratimit në Kuvend, hynë në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Autoritetit Mbikëqyrës si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

4. Këtij vendimi i bashkëngjiten: Raporti Përfundimtar Nr.08-320/01-26224/2025 i datës 14.10.2025 si dhe shkresat tjera përcjellëse.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL; Kryetari i Komunës; Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë (përmes kësaj drejtorie, vendimi dërgohet në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave dhe në Komisionin Qendror të themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës); Arkivi.



Kryetari i Kuvendit
Seladin Troni